



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

KPPP.nr. 510/22

GJYKATA KOMERCIALE, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Hasan Kryeziu, në çështjen përbarimore të kreditorit Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale, me seli në Prishtinë, rr. “Armend Daci” nr.1, kundër debitorit N.T “D...”, me NRB, me pronar SK, me seli në seli Komuna e Pejës, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përbarimor P.nr. 695/19, të datës 10.12.2019 të Përbaruesit Privat Shpend Ahmetaj, me seli në Pejë, jashtë seancës me datën 30.09.2022, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET në tërësi si i pabazuar prapësimi i debitorit N.T “D...”, i paraqitur kundër Urdhrit Përbarimor P.nr. 695/19, të datës 10.12.2019, i lejuar nga Përbaruesi Privat Shpend Ahmetaj.
- II. MBETET NË FUQI Urdhri Përbarimor P.nr. 695/19, i datës 10.12.2019, i lejuar nga Përbaruesi Privat Shpend Ahmetaj.

A r s y e t i m

Kreditori Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale ka parashtruar propozim për përbarim kundër debitorit N.T “D...”, për përmbushjen e detyrimit sipas dokumentit përbarues - Aktvendimit të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale Nr.4766 të datës 21.12.2018, i formës së prerë prej datës 27.01.2019 dhe i ekzekutueshëm prej datës 11.02.2019, me të cilën debitori është obliguar që kreditorit në emër të borxhit t’ia paguaj shumën prej 2,667.94 €.

Përbaruesi Privat Shpend Ahmetaj, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale, me datën 10.12.2019, ka lëshuar Urdhrit Përbarimor P.nr. 695/19, me të cilin ka lejuar përbarimin në bazë të dokumentit përbarues-Aktvendimit të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale Nr.4766, të datës 21.12.2018 me të cilën është urdhëruar debitori që t’ia paguaj kreditorit në emër të borxhit shumën prej 2,667.94 € si dhe shpenzimet e procedurës përbarimore me ndalim të mjeteve në para të cilat debitori i ka

në të gjitha llogaritë bankare dhe bartjen e shumës përkatëse në llogaritë e kreditorit, si dhe regjistrimin, konfiskimin, dhe shitjen publike të sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme të debitorit dhe nga shitja e këtyre të realizohet borxhi ndaj kreditorit si dhe të paguhet shpenzimet e procedurës përbarimore në pajtim me tarifën në fuqi.

Debitori N.T “Doni”, brenda afatit ligjor ka paraqitur prapësim me shkrim, me të cilën e ka kundërshtuar në tërësi urdhrin përbarimor duke theksuar se propozimi për përbarim nuk është bërë në pajtim me dispozitat nga nenin 38 i LPP-së, meqenëse kreditori ka bashkëngjitur aktvendimin në fotokopje dhe pa u vërtetuar tek organi kompetent, duke shtuar se urdhri për caktimin e përbarimit është marrë me shkelje të nenit 71 par.1 pika 1.1 dhe 1.4 e LPP-së, dhe se bazuar në nenin 352 dhe 355 të LMD-së kërkesa e kreditorit është parashkruar pasi që detyrimi i debitorit është i vitit 2007 dhe 2008 dhe se ka skaduar afati kohor brenda të cilit mund të kërkohej përbarimi. I ka propozuar gjykatës që të pranohet si i bazuar prapësimi, të priset urdhri përbarimor dhe të përfundohet përbarimi në tërësi.

Kreditori me përgjigje në prapësim, i ka kundërshtuar pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim duke theksuar se prapësimi i debitorit nuk përmban kurrfarë arsytimi të bazuar në fakte dhe prova duke theksuar se në bazë të nenit 69 par. 5 të LPP-së, prapësimi mund të paraqitet ekskluzivisht sipas dispozitave të nenit 71 të LPP-së, i cili duhet të mbështetet në prova të duhura. Ka theksuar se propozimi për përbarim është bërë në pajtim me nenin 38 të LPP-së, pasi që dokumenti në bazë të së cilit është kërkuar përbarimi është kopje e vërtetuar nga KPMM dhe se vërtetimi i këtij dokumenti është bërë nga i njëjti organ me anë të vulës nga arkiva në pajtim me kompetencat që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi. Ndërsa sa i përket pretendimit të debitorit se në këtë rast është parashkruar kërkesa konform nenin 352 dhe 355 të LMD-së, ka theksuar se kjo është çështje kontestimore që pala ka pasur të drejtë për ankesë dhe se debitori nuk e ka shfrytëzuar të drejtën e tij në ankesë ndaj aktit administrativ dhe se një pretendim i tillë nuk qëndron për faktin se aktvendimi nr. 4766 i datës 21.12.2018 është bërë i formës së prerë me datën 27.01.2019 dhe i ekzekutueshëm me datën 11.02.2019 ndërsa propozimi për përbarim është bërë me datën 06.12.2019 brenda afatit të paraparë ligjor. I ka propozuar gjykatës që të refuzohet si i pa bazuar prapësimi i debitorit dhe të mbetet në fuqi urdhri përbarimor.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes në prapësim të kreditorit dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës,

duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përbarimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është në tërësi i pabazuar andaj të njëjtin e refuzoi dhe vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, për shkaqet si në vijim:

Gjykata vlerëson se organi përbarues ka lejuar përbarimin bazuar në nenin 21 të LPP-së i cili përcakton se: *“Organi përbarues e cakton, përkatësisht e zbaton përbarimin vetëm në bazë të dokumentit përbarues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër.”*

Gjykata ka shqyrtuar dokumentin përbarimor, përkatësisht Vendimin Nr.4766, në bazë të së cilit përbaruesi privat ka lejuar përbarimin dhe gjeti se i njëjti, sipas nenit 22 paragrafit 1, nën paragrafi 1.2 të LPP-së, është përcaktuar si dokument përbarues sipas të cilit mund të caktohet përbarimi për realizimin e kërkesës në të holla. Gjykata gjeti se Vendimi Nr.4766, i përmban të gjitha elementet e përcaktuara në nenin 27 paragrafin 1, sipas të cilit: *“Dokumenti përbarimor është i përshtatshëm për përbarim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit”*, pasi që në të është treguar kreditori, debitori, objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit.

Gjykata vlerëson se në rastin konkret Aktvendimi Nr.4766 i datës 21.12.2018, i plotëson kushtet e përcaktuara në nenin 36 paragrafin 1 të LPP-së, sipas të cilit përcaktohet se: *“Së bashku me propozimin për përbarim, organit përbarues i dorëzohet edhe dokumenti përbarues, origjinal apo kopje e vërtetuar, me klauzolën e përbarueshmëris për përbarueshmëri”*, dhe paragrafin 2 të po të njëjtit nen, sipas të cilit përcaktohet se: *“Vërtetimin për përbarueshmërin e jep Gjykata, respektivisht organi shtetëror që ka vendosur për kërkesën në procedurën e shkallës së parë”*, ngase Aktvendimi Nr.4766 i datës 21.12.2018, i nxjerrë nga Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale, është dorëzuar në kopje të vërtetuar, i njëjti është bërë i formës së prerë me datë 27.01.2019 dhe i ekzekutueshëm me datë 11.02.2019.

Gjykata po ashtu vlerësoj pretendimet e debitorit në prapësim se kërkesa e kreditorit është parashkruar konform nenit 352 dhe 355 të LMD-së, dhe erdhi në përfundim se një pretendim i tillë i debitorit është pa mbështetje ligjore, ngase në këtë procedurë kjo gjykatë nuk mund të lëshohet në vlerësimin e ligjshmërisë së vendimit dhe përmbajtjes së dokumentit përbarimor meqenëse procedura përbarimore i nënshtrohet parimit të rigorozitetit formal, në bazë të cilit ndalohet

vlerësimi i rrethanave tjera, përpos vlerësimit të elementeve formale të dokumentit në bazë të cilit është lejuar përmbarimi.

Nga arsyet e paraqitura më lartë dhe duke u bazuar në nenin 73 par.1 dhe par. 3 të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE, Dhomat e Shkallës së Parë

Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.510/22, datë 30.09.2022

Gjyqtari

Hasan Kryeziu

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi

palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve,

nga dita e pranimi të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë,

në Gjykatën Komerciale, në Prishtinë, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.